AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, 2020-2023

16.02.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për vitet 2020-2023.

Rritet indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vendet të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, blegtorale dhe totali i prodhimeve bujqësore për vitet 2020-2023, (2020=100)



Ndryshimi vjetor i indeksit në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 në %

Në vitin 2023, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore kishte rritje për (14,0%), krahasuar me vitin 2022. Ndërkaq, indeksi i çmimeve prodhimeve blegtorale kishte rritje për(11.6%) në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022. Kurse, indeksi i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore kishte rritje për (13.1%) në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022.

Ndryshimi në %, viti 2023 me vitin 2022

Përshkrimi	2022	2023	Ndryshimi në %
Prodhimet bimore	135,1	154,0	14,0
Prodhimet blegtorale	124,2	138,7	11,6
Totali prodhimeve bujqësore	131,0	148,2	13,1

Ndryshimi vjetor i indeksit në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020 në %

Në vitin 2023, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bimore kishte rritje për 54,0%, krahasuar me vitin 2020. Ndërkaq, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale kishte rritje për 38,7% në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020.

Kurse, indeksi vjetor i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore kishte rritje për 48,2% në vitin 2023, krahasuar me vitin 2020.

Ndryshimi në %, viti 2023 me vitin 2020

Përshkrimi	2020	2023	Ndryshimi në %
Prodhimet bimore	100,0	154,0	54,0
Prodhimet blegtorale	100,0	138,7	38,7
Totali prodhimeve bujqësore	100,0	148,2	48,2

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Për më shumë informata lidhur me Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, për 2020- 2023 (2020=100), vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Agriculture